

KOSOVARJA

FITIM THAQI DHE “DRINI MARKET”:

Historia e një ëndrre
që u bë realitet



GRAND PRIX COLLECTION



BOSS
WATCHES

ias
WATCHES - JEWELRY - OPTICS

SKYTRAVELLER COLLECTION



BOSS
WATCHES

WWW.IAS-KS.COM



Fitim Thaqi dhe “Drini Market”: Historia e një ëndrre që u bë realitet

Në një qytet të madh gjerman, larg fshatit të vogël të lindjes në Kosovë, rruga drejt suksesit shpesh duket e gjatë dhe e vështirë. Për Fitim Thaqin, 31 vjeç, kjo rrugë ka qenë sfidë dhe mundësi njëkohësisht.

Pas viteve të para të vështira në Gjermani, ai ka arritur të ndërtojë një biznes që jo vetëm promovon produktet kosovare, por edhe krijon një urë mes diasporës dhe vendit të tij.

Historia e tij tregon se ëndrrat realizohen me punë të palodhur, korrektësi dhe pasion.





NGA NJË FSHAT I VOGËL - NË SFIDAT E QYTETIT TË MADH

Fitim Thaqi është i lindur në Sapniq, fshat i vogël i komunës së Rahovecit.

Në vitin 2007, së bashku me familje, emigroi në Gjermani, duke u bashkuar me babanë që kishte jetuar aty më parë. Vitet e para nuk kanë qenë të lehta: qyteti i madh, gjuha e huaj dhe sfidat e shkollimit kërkonin përqendrim dhe këmbëngulje.

"Fillimi ka qenë i vështirë, por gjithmonë kisha një ëndërr: të bëhem profesionist në tregti", tregon ai.

Pas përfundimit të shkollës dhe punës në kompani të mëdha si "Rewe Group" dhe "Edeka Süd Bayern", Fitimi mori hapat e parë drejt biznesit të tij.

NGA PUNËTOR U BË SIPËRMARRËS

Çelësi i suksesit të Fitimit ka qenë puna e madhe dhe qëndrimi korrekt ndaj konsumatorëve dhe bashkëpunëtorëve.

Nga një menaxher në një kompani të njohur, ai u bë pronar i "Edeka Thaqi", duke shpërblyer gjithë vitet e sakrificës dhe përkushtimit.

"Është e mundur për çdo shqiptar që të arrijë atë që dëshiron. Nuk ka sekret tjetër përveç punës së madhe dhe sinqeritetit", shprehet ai.

PROMOVIMI I PRODUKTEVE KOSOVARE DHE ËNDRRA E FIRMËS "DRINI MARKET"

Një nga pikat kryesore të strategjisë së tij ka qenë importimi i mallrave nga Kosova.

“Si vendas i Rahovecit, e dija se produktet tona kanë cilësi dhe mund të jenë të suksesshme në tregun gjerman dhe më gjerë”, thotë ai. Nga kjo ide lindi “Drini Market”, një koncept i veçantë që përqendrohet te produktet shqiptare dhe kosovare, me një gamë të gjerë dhe shërbim online për diasporën.

“Drini Market”, jo vetëm promovon produktet vendore, por, gjithashtu, krijon një ndjenjë nostalgjie dhe komuniteti për shqiptarët në Gjermani.

“Drini Market” nuk është vetëm një market, por një urë lidhëse ndërmjet komuniteteve dhe biznesit vendor.

Konsumatorët reagojnë pozitivisht, duke rikthyer besnikëri dhe duke ndjerë “një copë shtëpie” larg vendit të tyre.

Vizioni i Fitimit është i qartë: Zgjerimi i “Drini Market”-it jo vetëm në Gjermani, por në gjithë Evropën.

Andaj, tri pika të reja do të hapen së shpejti në Bavari, duke e çuar konceptin e tij edhe më larg.

MESAZHI PËR TË RINJTË SHQIPTARË...

Në jetën personale, Fitimi pranon se puna shpesh merr përparësi mbi kohën për familje dhe hobi.

Por, për të çdo sakrificë ka një kuptim të madh.

Për të rinjtë shqiptarë mesazhi është i qartë: Duaje vendin tënd, ndjek ëndrrat tua dhe puno shumë që t'i realizosh ato!

“Ëndrrat realizohen kur ke vizion, pasion dhe punë të palodhur”, është rezymeja e Fitimi Thaqit.

Nderim Neziri



Gjenerali me plis



Më 23 janar të vitit 1916, në Podgoricë të Malit të Zi, brenda disa minutave vriten të gjithë: Isa Boletini, dy djemtë e tij studentë në Vjenë, dy nipërit...

Nuk e hiqte kurrë kostumin popullor dhe e mbante një kobure të fshehur kudo që shkonte.

Ishte njeriu i fortë i Ismail Qemalit dhe organizoi forcat e armatosura për mbrojtjen e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës.

Kthesa fatale e jetës së tij duket se nisi një vit pas shpalljes së pavarësisë në Vlorë, me përfshirjen e Kosovës nën Jugosllavi, sipas vendimeve të Fuqive të Mëdha në takimin e Londrës më 1913.

Legjendat për vrasjen e tij janë të shumta, por një botim i vitit 1971 jep me detaje një skenë krimi ku duket se janë implikuar autoritetet malazeze dhe diplomatët francezë të kohës. Botimi i 1971 jep një dëshmi të nipit të mbijetuar nga ngjarja, Tafil Boletinit.

Në vitin 1915 malazezët pushojnë Shkodrën.

Isa Boletini kërkoi ndihmën e ndërkombëtarëve. Francezët ofrohen dhe konsulli i tyre në Shkodër i thotë Isa Boletinit dhe njerëzve të tij që të shkojnë në Ambasadën Franceze në Cetinë, asokohe kryeqytet i Malit të Zi, nga ku do të marrin vizë për të shkuar në një vend neutral.

Anglezët, më bujarë, e ftojnë Boletinin ta marrin nën mbrojtje, por nisur nga ligjet e

maleve, ai preferon "mikun që i hapi derën i pari".

Boletini dhe njerëzit e tij mbërrijnë në Cetinë dhe fillimisht bëjnë një vizitë në ambasadën franceze.

Pak orë më pas, në mëngjes, Isa Boletini sheh se shtëpia ku rrinte ishte rrethuar me xhandarë malazezë.

Ata e shoqërojnë atë bashkë me njerëzit më të afërt në Danilograd dhe më pas në Podgoricë.

Më 23 janar 1916, në ditën kur malazezët po u dorëzonin kryeqytetin pa luftë austriakëve, është dhënë urdhri për vrasjen e Boletinit.

Ja rrëfimi i Tafilit, nipit të Isa Boletinit, që i mbijetoi ngjarjes, sipas librit të Skënder Luarasis:

"Rreth 80 xhandarë ishin në të dyja anët e urës së Ribnicës, karshi prefekturës, afër kishës katolike.

Unë me dy vëllezërit, sipas lajmërimit po ktheheshim për në shtëpi, te axha Isë.

Patrulla në krye të urës na ndali. Xhandarët pyetën: "Kush asht Isa Boletini?!"

Por, oficeri ndërhyr duke u thënë: "Mos shtini, nuk është asnjë nga këta!"

Në këtë kohë Isa Boletini, vetë i teti, kishte hedhur hapat e parë në dërrasat e urës së Ribnicës.

Një oficer u kërkon të dorëzojnë armët, por Isa Boletini kundërshton.

I pari që shtie ishte një Pero Buriqi nga Vasoviçi.

Menjëherë flakë për flakë përgjigjet edhe Isa Boletini dhe të tjerët me nga dy revole në duar.

Brenda disa minutave vriten të gjithë: Isa Boletini dhe të bijtë, Halili dhe Zahidi (studentë në Vjenë), dy nipërit, Jonuzi dhe Halili, pastaj Hajdar Selim Radisheva, kunati i Isait, djali i vëllait të Hajdarit, Idriz Bilimi dhe Misin Bala nga Isniqi".

NUK ËSHTË I VETMI ZEKERIA CANA QË HARROHET!



Prof. Cana te "Verrat e Llukës"

Janar i këtij motmoti. Çuditërisht, janari është muaji në të cilin kanë vdekur njerëzit, personalitete të mëdha të kombit tonë, të historisë sonë. Por, në këto raste, të shkon në mendje pyetja: Pse disa emra të njohur nuk përkujtohen fare? Madje, as në përvjetorët e tyre të vdekjes!

10 janar i këtij motmoti.

Përcjell portalet tona të kësaj dite. Asnjë fjalë për prof. Zekeria Canën në shenjë përkujtimi.

Në mbrëmje përcjell edhe ekranet televizive, lajmet... As ato - asnjë fjalë për profesorin e nderuar, burrin e madh të Kosovës.

Virtytet e profesor Canës do të kujtohen dhe do të nderohen përherë nga qytetarët e Kosovës - thoshin pushtetarët në telegrame ngushëllimi ato ditë kur ai vdiq.

Por, nga ato ditë e sot, profesor Cana sikur u harrua... U harrua njeriu i cili në dy dekadat e fundit të shekullit XX që bërë simbol i rezistencës ndaj dhunës, përndjekjeve, tmerreve dhe vrasjeve të shqiptarëve.

Me këtë çast, se ç'më kujtohet marsi i përvjetorit të parë të pasluftës i rënies së komandantit legjendar Adem Jashari, që mbahej në Prekaz.

Dhe, derisa atje mbahej organizimi, takohem me profën në kafenenë "Bagrem". Në sytë dhe fytyrën e tij lexohej qartë se ishte i pa disponuar, i zhgënjyer, i rraskapitur...

"I thyer jam sot, Gani Dili", më drejtohet me fjalët e para, thuajse e kuptoi shqetësimin tim. "Sot, në përvjetorin e parë paslufte, e që me duart e mia e lëshova në dhe Ademin, unë atje mungoj".

"Pse?", e pyes.

"Nuk më kanë ftuar!"

Po këto fjalë m'i thotë edhe në natën e kremtimit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, teksa liderët dhe shumëkush cakërronte gotat në emër të Pavarësisë. U habita kur dëgjova fjalët e profesorit nëpërmjet telefonit se as në këtë solemnitë nuk e kishin ftuar...

Por, pavarësisht nga këto, emri i profesor Canës mbetet i përjetshëm në historinë e Kosovës, sepse edhe Ai e ka hisen e vet. Ai edhe në kushtet e regjimit serb krijoi e lartësoi dinjitetin e shqiptarit...

Andaj, a nuk është turp të mos kujtohet ky vigan i historisë shqiptare, ky patriot i madh që shkriu gjithçka për popullin e Kosovës?!

Ai, kush tjetër e meriton të përkujtohet?

S'ka nevojë të përmenden daljet e tij në ballë të demonstratave kundër regjimit serb, as në ballë të tubimeve për Pajtimin e Gjaqeve krah Anton Çettës, as në konferencat e shtypit krah Ibrahim Rugovës, e as për 39 burgosjet e tij...

Por, nuk është i vetmi Zekeria Cana që nuk përkujtohet! Edhe shumë të tjerë nuk i përkujtojmë, i lëmë në harresë...

Rrallë përmendet, për të mos thënë fare, akademik Fehmi Agani, shtylla qendrore e LDK-së një dekadë të tërë!

Pastaj, aktorët e mëdhenj: Abdurrahman Shala, Bekim Fehmiu, Shani Pallaska, Malo Gami, Ragip Loxha, Melihate Ajeti, Avdush Hasani, e shumë të tjerë...

Shkencëtarët: Gazmend Zajmi, Ali Hadri, Idriz Ajeti...

Poetët: Esad Mekuli, Enver Gjerqeku, Din Mehmeti, Mirko Gashi...

"Babai i Revistave" - gazetari Ali Sutaj, Maksut Shehu...

Emra këta që kanë bërë histori, kanë lënë gjurmë në çdo segment të Kosovës e për Kosovën...

Harresa e këtyre emrave është vrasje e historisë, turp i kohës që s'falej nesër...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com


Nostalgji



Sadik Selmani (djathtas) me Binak Arifin e Geg-hysenit



★★★★★
Hotel Garden®
Prishtina



Hotel Garden: +383 45 71 71 77; Garden Downtown: +383 48 71 71 77;
Website: www.hotelgarden-ks.com; Instagram: /garden_hotels

A ka Prishtina plazh?

"Edhe pse dimër, as që brengosëm pse dal në rrugë me kërthizë të zbuluar! Nuk preferoj të vishem në këtë mënyrë që të provokojë ndokënd, por pse më pëlqen dhe nuk kam të ftohtë. Mua më shkojnë për shtati veshjet me kërthizën jashtë", thotë Aranita, maturante e një shkollë të mesme në Prishtinë.

Ekspozimi i kërthizave nga femrat e reja është një "nxehhtësi shpirti" në këtë dimër të ftohtë që e ka kapluar Kosovën.

Sidoqoftë, hyrja në modë e zbulimit të kërthizës së një femre tërheq ndjenjat seksuale të mashkullit...

Por, ka edhe femra të cilat mendojnë se zbulimi i kërthizës nuk është normale për mentalitetin tonë.

Në anën tjetër, ka femra që as që e lodhin kokën se çka mendojnë të tjerët për veshjen dhe dukjen e tyre. E, se është kështu më së miri tregon Veranda, shitëse në njërin nga butikët më të njohur në Prishtinë, e cila thotë se shumë femra vijnë dhe kërkojnë veshje sa më provokuese, ani pse është dimër dhe bën të ftohtë, thuajse kanë për të dalë në plazh e jo në borë.

Megjithatë, thotë Veranda, femrat e reja po i zbukuron nxjerrja e kërthizës jashtë, pa marrë parasysh se në cilën stinë të vitit jemi...

KUSH PO I MËSON TË REJAT TA NXJERRIN KËRTHIZËN JASHTË?

Këtë shfrenim të disa vajzave e kanë vërejtur më së miri ata që kanë ardhur për pushime të Vitit të Ri në Kosovë, e që sivjet numri i tyre ishte shumë i madh, mbase edhe nga nevoja për të votuar, meqë zgjedhjet e fundit u mbajtën 3-4 ditë para Vitit të Ri.

"Jetoj dhe punoj në Gjermani. Thënë shkurt, atje femrat dimrit nuk dalin me kërthizën jashtë, siç më ka rënë t'i shosh shumë sosh në disa lokale, e aq më keq rrugëve të Prishtinës, e që ma kujton verën në plazh.

Nuk di kush po i mëson, kush po i "evropianizon" të rejat tona", thotë Fadil Fazliu, me qëndrim në Gjermani.

Por, mendim krejt tjetër ka Aranita, nxënëse e njëres nga shkollat e mesme të Prishtinës, e cila sivjet është maturante.

"Edhe pse dimër, as që brengosëm pse dal në rrugë me kërthizë të zbuluar! Nuk preferoj të vishem në këtë mënyrë që të provokojë ndokënd, por pse më pëlqen dhe nuk kam të ftohtë. Mua më shkojnë për shtati veshjet me kërthizën jashtë", thotë Aranita, duke i vënë "kapak" kësaj pune.

Merita Ajeti





for your
Special moments

G GLAMOUR

Për rezervime na kontaktoni në Instagram: [glamourevnts.pr](https://www.instagram.com/glamourevnts.pr)

Femra e moralshme herëdokur del në selamet!

Derisa koha e mesitnive ka ikur, sot njohja më e madhe e të rinjve bëhet nëpërmjet internetit. Por, sa zgjasin ato lidhje, flasin të anketuarat tona...

**F. JONUZI, 37 VJEÇE,
NGA PRISHTINA:
NUK DUA TË MARTOHAM
NË KANADA!**

- Koha e mesitit ka kaluar. Jemi dhënë pas internetit. Nëpërmjet internetit ka mundësi të gjesh burrë, por sa zgjatë ajo martesë? Ka një vit që jam në lidhje me një person që jeton në Toronto të Kanadasë. Por, thënë të drejtën, në po mund ta bind veten që të martohem me të, sepse matanë Atlantikut s'kam dëshirë të martohem. Kam dëshirë të gjej një njeri që më merr për grua në ndonjë shtet të Evropës, sepse mundësia e lëvizjes është më e madhe, por edhe shkuarje-ardhjet janë më të lehta.

**E. MISINI, 40 VJEÇE,
NGA MITROVICA:
JAM E ZHGËNJYER, NUK
PRES TË MARTOHAM!**

- Isha dy vjet e martuar, por me burrë nuk gjetëm mirëkuptim, andaj edhe i mbledha rraqet dhe u ktheva te prindërit. Tash jam në pritje të ndonjë oferte të re, por e kam vështirë të vendosi, meqë "qer-

rja që thuhet një herë vështirë rregullohet!", më thonë prindërit. Një gjë dihet: Kur martesat bëheshin me mesitni kishte më pak ndarje, sepse mesiti ishte dorëzon dhe nuk thyhej lehtë fjalë e tij.

E unë, që u martova nga një njohje në internet, ashtu si u martova edhe u ndava! Keq, a?

**SH. AJETI,
41 VJEÇE, GJILAN:
I URREJ MESITËT!**

- Mesitët i urrej prej kohës kur në familjen tonë ndodhi një problem.

E fejuam kushërirën tonë me mesit në Zvicër. Kur takohet kushërira me personin që do e merrte për burrë, në takim kishte dalë vëllai i tij, e që edhe ai jetonte në Zvicër.

Ajo e pranon ofertën, por kur i erdhi koha të shkonte në Zvicër, burri i saj nuk ishte ai me të cilin ishte takuar!

Sidoqoftë, për të mos u kthyer sërish në Gjilan, martohet me të.

Por, edhe pse ajo tash i ka dy fëmijë, nuk është e lumtur me të dhe më shumë bënë jetë martesore shkaku i fëmijëve sesa nga dashuria që ka për burrin e vetë!

**L. V., 29 VJEÇE,
NGA DRENICA:
FEMRA E MORALSHME
HERË DO KUR DEL NË
SELAMET!**

- Jam 29 vjeçe dhe ende e pamartuar. Kam dëshirë të dal jashtë, sepse në rrethin ku jetoj nuk besoj se mund të kem një lidhje për martesë, përkundër asaj se jam munduar të gjej dikë që do më dojë, ani pse në aspektin moral jam plotësisht në rregull.

Shpesh i bëj pyetje vetes: Hë, çka fitova që si e re e ruajta moralin?

Në këtë pyetje vetëm fjalët e nënës i kam ngushëllim: "Bija ime, femra e moralshme herë do kur del në selamet!".

Dhe, këto fjalë më japin shpresë, më japin vullnet për jetë...

Si ta përmbyll këtë shkrim?

Teknologjia e ka bërë të veten. Shumë njohje tash bëhen nëpërmjet komunikimit në internet.

Por, edhe mesitnitë e dikurshme e kanë kryer punën si duhet.

Andaj, edhe njëra e edhe tjetra të shfrytëzohen për të mirën tonë...

D. Haxhaj


COURTYARD®

BY MARRIOTT

Prishtina

Shijoni Drekën e Punës në Zemër të Prishtinës!

Koncepti i Drekes se Punes ne Courtyard by Marriott Prishtina është i disponueshëm çdo ditë pune nga ora 11:30 – 13:30.





Në Bogë të Rugovës nuk flitet për politikë...

Rugova, dikur e lënë pas dore, megjithatë, tash është bërë e shtrenjtë, sepse edhe kodrat ku dikur mendohej se ishin të mira vetëm për dhi të egra, tanimë po shndërrohen në vendin më magjeps në Kosovë, sepse ajri i pastër, i kërkuar për shërim, gjendet mu këtu. Dhe, çka jo tjetër...

Të dielën e dytë të janarit të sivjetmë Rugova gjallëronte nga njerëzit që mësynin peizazhin natyror që i takon Kosovës. Kudo gjallëri.

Që nga fillimi i kanjonit afër Pejës e deri në Bogë, kolona e automobillave m'i kujtonte dasmat e verës. Përgjatë lumit rridhte uji i kthjellët. Fluksi i njerëzve nuk ik nga syri dhe dinamika as te vendi i restorantit "Gryka", por as te shumë

objekte të reja hoteliere, e që kanë lulëzuar përgjatë kodrave malore jo shumë larg rrugës me asfalt që shpie deri në Bogë dhe te Moteli "Dheu i kuq" në Kuqishtë, mbi objektin famëkeq "Kulla e Rankoviqit", që tani është vetëm për histori. Pamje të mirë kanë edhe krojet e "Sali Ramës" me ujë të ftohët, burim i ngritur nga bijtë e ish-komitës Sali Rama, por edhe rapsodit të madh, e që ishte vënë

në ballë të aksioneve kundër çetnikëve në Rugovë, në periudhën ish-komuniste pas Luftës së Dytë Botërore.

Me të arritur në Kuqishtë, ku ndahet rruga për në Çakorr dhe Bogë, dy drejtime të cilat dalin në Mal të Zi, përfundon asfalti.

Rugova, si visi më i lartë malor i Kosovës, është në fazën e gjallërisë më të madhe turistike, ekonomike dhe blegtorale. Aty po lulëzon një



zonë e re turistike dhe po investohet në çdo lëmi të jetës.

Sherifi, që qëndronte në afërsi të Mullirit të Isufit, te Kulla e Rankoviqit, e që kishte dalë të sodiste natyrën të mbuluar nga bora e bardhë, thotë se Rugova është vend shërues.

“Kjo lartësi shëron zemrën dhe sëmundjet nga astma. Kush ka probleme me zemër dhe me mushkëri nuk do të gjejë vend më të mirë se ky për t’u shëruar.

Ajri i pastër ndihmon shërimin e njerëzve, prandaj ky vend edhe po shfrytëzohet shumë mirë nga njerëzit si gjatë verës ashtu edhe dimrit.

BOGA DHE SHIJIMI I BUKURIVE NATYRORE EDHE NË DIMËR

Boga, fshat me rreth 150 shtëpi, siç thotë njëri nga kamerierët nga Hoteli “Magra Austria”, është në ngritje e sipër dhe ndodhet në qendrën e skijimit dimëror.

Bogaj, fshati i fundit kufitar me Malin e Zi, shfrytëzohet nga mijëra vizitorë dhe njerëz që kanë synim

shijimin e bukurive natyrore si gjatë verës ashtu edhe gjatë dimrit.

Dhe, pas një shëtitje të mirë në natyrë dhe një ndeje në Hotelin “Magra Austria”, para perëndimit të diellit ia kthej shpinën Rugovës dhe marrë rrugën për në Prishtinë.

Gjatë rrugës më rrinte në mend shëtitja e mrekullueshme dhe vetvetiu u binda se me këdo që bisedova, madje edhe me kamerierët ku pija kafe, nuk hasa në askënd të flasë për politikë, gjë që në Prishtinë njerëzit nuk dinë të bisedojnë tjetër veç politikës...

Isa ILAZI

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Shkabaj
Fillo këtu.
www.shkabaj.net

Kush janë “trimat” që rrahin gjoks se u kënaqën?

Jemi dhënë shumë pas politikës, kurse e kemi harruar një temë shumë të nxehtë – temën e moralit, e që përherë është aktuale...

Në këtë shkrim do të bëjmë fjalë vetëm për moralin e burrave, por jo edhe të grave, sepse tema është e gjerë dhe nuk mund të shkojë me një a dy shkrime.

Thënë shkurt, për moralin në Kosovë flitet me gjuhën më të pamoralshme. Pse?

Sepse janë të rrallë ata burra mbi të 50-at e që nuk krekosen për biografi “të pasur” me dashnoret e tyre, duke përmendur numër të madh të fem-

rave që i kanë pasur gjatë karrierës së tyre...

E, kjo të krijon përshtypjen se në Kosovë nuk ka femër të virgjër, sepse të gjitha kanë kaluar nëpër duart e burrave që rrahin gjoks se janë kënaqur dhe po kënaqen!

E, në anën tjetër, disa sish kanë bërë gjithçka, por nuk flasin haptazi, paraqiten serioz kinse nuk e shkelin as bubrrecin...

Shtrohet pyetja: Kujt t’i besohet?

Sidoqoftë, për moralin apo edhe për dukuritë amorale nuk debatohet haptazi në media apo në instanca të tjera, por jemi dhënë pas debateve politike se kush i fiton zgjedhjet, cila parti fiton më shumë deputetë, cila parti e formon qeverinë, e të tjera të ngjashme, e që janë bajatizuar dhe të krijojnë nervozë sa herë që i sheh të njëjtit analistë në televizionet tona! Keq, a?

Diturie Haxhaj

Cili kosovar jetoi 50 vjet në bunker?

Një kullë e vjetër me dritare sa për ta vendosur tytën e manzerës, rënkon e lodhur nga stuhitë e kohëve. Është shtëpia e vetme në vitin 2005, e cila qëndron në atë gjendje sikur është ndërtuar gjysmë shekulli më parë. I zoti i saj është njeriu që ka jetuar në bunker, që hyrjen e ka në oborr e fundin sa kilometra prej aty, në mal.

Avdyl Bajrush Gavazi, që shkurt e quajnë (Daku), 70 vjeç, nga fshati Mirash i komunës së Ferizajt, është legjendë në vete. Historia e tij është formuar në raport me Serbinë dhe përndjekjen e tij për shumë dekada. Pushteti komunist serb e akuzonte tërë jetën për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat, këto të fundit, kërkim aktesh e letrash që e lidhnin Dakun me Tahir Mehën e Drenicës dhe me disa patriotë të tjerë që kishin shkathtësi fizike të mos binin në duart e policisë serbe. Avdyl Gavazi, të dielën e tre janarit të vitit 2005, dilte nga shtëpia e rrëzbitur, i mbushur frymë, me një kollitje të thekshme, rrëzë malit, në një qosh të fshatit, i përmalluar të flet për njerëzit dhe të bërat e tij...

Ka jetuar në izolim më se pesëdhjetë vjet, në maje malesh të thepisura, i ruajtur nga truprojat më besnike, nga pesë qentë e tij të mëdhenj, në një korridor bunkerit të ndriçuar nga llamba e vajgurit. Njeriu që ka jetuar në mënyrën më të çuditshme për nga mjeshtëria, me mjekër të thinjur dhe me plis e mahramë, i rikujton disa gjëra të hidhura nga jeta e rëndë, qëkur ia vranë partizanët babanë, Bajrushin, në vitin 1947, si ballist i përbetuar për bashkim me Shqipërinë dhe armik i komunizmit.

Qan e flet kur i kujton njerëzit dhe shokët, rrahjet me policët e komunizmit, borën një metër të trashë mbi shpinën e tij, tek dremitej me kokë në jastëkun prej druri dhe guri në krye të bunkerit që dilte te vendi i quajtur "Kodra e Kishës" në bjeshkë. Avdyl Gavazi ishte kërkuar edhe nga shërbimi ushtarak i shtetit jugosllav, sepse policët nuk e kishin kapur kurrë dhe, si i tillë që ishte, ai kishte zgjuar frikën e regjimit për organizime ushtarake.

AVDYLLIT SERBIA KURRË S'IA LA KILE

Njeriu që jetoi tërë jetën me nder e drejtësi, që në moshën dhjetëvjeçare reagoi me pushkë kundër Serbisë, që instalonte partizanë, që Daku i quan "partizanët e Sllakocit".

"Isha dhjetë vjeç kur ua ktheva pushkën partizanëve. Unë nuk munda t'i zbrapsja, sepse isha shumë i ri, por prej atëherë më

kurrë s'mu hoq gazepi", thotë Avdyl. Ai betohet në emrat e dy njerëzve S. Q. dhe A. G., që ia shpëtuan jetën mbi 100 herë, pasi, si bashkëvendës, e kishin mbrojtur fuqishëm. Ata e kishin mbrojtur, të paktën, të mos e vrisnin, sepse Daku kishte akuza të rënda që i ngarkoheshin...

Ai tregon se e kanë ndjekur brigadat partizane për ta zhdukur nga faja e dheut, si dhe uniformat policore – ushtarake. "Prej atëherë kurrë s'kam pasur selamet", thotë Avdyl Gavazi, njeriu të cilin e kanë quajtur "komandanti i ballistëve". Ai tregon se i kanë rënë njerëzit e UDB-së në shtëpi, por edhe për çdo gjë që ka ndodhur jo vetëm në fshat, por edhe në rrethinë e më larg.

Për një pjesë të jetës së vet të mundimshme, ai thotë: "Pesëdhjetë vjet nuk kam pasur liri në shtëpinë time! Ka pasur të tillë në fshat që më thoshin: "Ku je ballist"? E unë, s'mund t'u thosha se s'jam i tillë, pasi babai, Bajrushin, ishte vrarë për ideal të tillë.

Më së paku njëqind herë më kanë rënë në shtëpi, duke m'i nxjerrë njerëzit e shtëpisë përjashta!

Hallat e motrat, si dhe bijat e shtëpisë, shumë herë kanë ngrënë dajak me kondak pushke, duke i rrokullisur shkallëve prej druri në çardak.

I kanë pasur eshtrat e thyer prej dhunës serbe që ua bënin në shtëpi", thotë Daku me lot në sy, për dhembjen që e ndjen akoma ndaj anëtarëve të familjes, derisa tregon se kurrë për aq vite regjimi i Serbisë nuk ia la kile...

"Sa herë më kanë rrahur ua kam kthyer,

bile edhe më shumë! Sa herë më kanë sharë e ofenduar, ua kam kthyer njëjtë. Sa herë janë paraqitur butë, edhe unë jam paraqitur butë ndaj tyre", i kujton me lot në sy Daku të gjitha ngjarjet e jetës së tij.

TRUPROJAT BESNIKË TË DAKUT

Njeriu që pohon të ketë fjetur në gurë, në vend të jastëkut, ka pasur pesë truproja besnikë, që ishin qentë e tij, që rrinin në hyrje të bunkerit. Qentë e tij kanë vrarë ujqërit që i janë ofruar bunkerit, e që ishte shtëpia e Avdylit.

Dhe, për të gjitha këto, Daku thotë: "Bunkerin e kam ndriçuar me fener vajguri. Ushtria serbe ka ardhur me qenë speciale për t'më kapur, por qentë e mi kanë fituar karshi qenve të ushtrisë jugosllave. Forcat jugosllave kanë zbritur me parashutë për t'më kapur në befasi, por pa sukses...

KUR U KTHYE DAKU NË SHTËPI?

Daku ka zbritur në shtëpinë e tij me filimin e shkatërrimit të Jugosllavisë, i përballur me skamje dhe vuajtje, nën diktatin e sëmundjeve që i solli mali dhe koha. Në luftën e vitit 1999, në oborrin e shtëpisë së vet, u ka dalë përpara tankeve të ushtrisë serbe dhe u ka bërë titur: "Qëlloni në këtë gjoks!".

Por, për çudi, nuk e vrasin! E habitshme, a?

(Shkrim i realizuar në janar të vitit 2005)

Safet Krivaça



Janari: muaji i fillimeve të mëdha dhe energjisë së ulët!



Janari shpesh përjetohet si muaji më i rëndë emocional i vitit, jo sepse “diçka nuk shkon me ne”, por sepse disa faktorë bashkohen në të njëjtën kohë. Viti i ri nis me dëshira, synime dhe pritshmëri të mëdha: vendime të reja, plane të reja, një ide se “këtë herë do të ndryshoj gjithçka”. Por pas pak ditësh, shumë njerëz e vërejnë se energjia bie, motivimi zbehet dhe entuziazmi i fillimit nuk përputhet me realitetin e përditshëm. Në këtë pikë, mendja e interpreton sikur kemi dështuar, edhe pse ajo që ndodh është shpesh krejt normale: trupi dhe psikika po reagojnë ndaj dimrit, ritmit, lodhjes dhe mungesës së dritës.

Psikologjikisht, janari ka disa “tronditje” tipike. Së pari, vjen rënia pas festave: pas një periudhe sociale intensive, shpenzimesh, ndryshimesh në gjumë dhe ushqim, rikthimi në rutinë mund të ndihet i ashpër. Kjo gjendje shpesh përshkruhet si “post-holiday blues”,

ku përzihen lodhja emocionale, pritshmëritë e parealizuara, presioni financiar dhe ndjesia se “tani duhet të jem menjëherë produktiv”. Së dyti, ka faktorë biologjikë: ditët janë më të shkurtra, ka më pak dritë natyrale dhe kjo lidhet me ritmin cirkadian dhe kimikatet e trurit që ndikojnë humorin dhe energjinë. Për disa persona, sidomos ata të ndjeshëm ndaj ndryshimit të stinëve, mungesa e dritës shoqërohet me ulje të serotoninës dhe ndryshime në melatoninë, duke sjellë përgjumje, rënie energjie dhe humor më të ulët. Këtu hyn edhe termi që njerëzit e përdorin shpesh: “winter blues” (bluzi i dimrit). Ai përshkruan një gjendje të lehtë deri mesatare të rënies së humorit gjatë dimrit, me apati, lodhje, dëshirë për t’u izoluar, gjumë më të gjatë dhe motivim më të ulët. Për një pjesë më të vogël të njerëzve, simptomat mund të jenë më të thella dhe të qëndrueshme dhe atëherë flasim për Çrregullimin Afektiv Sezonal (SAD), një formë depresioni e lidhur me stinët, që lidhet me mungesën e dritës dhe përsëritet në një model të ngjashëm çdo vit.

Megjithatë, janari nuk është vetëm “muaj i vështirë”; ai mund të jetë

edhe një mundësi. Pikërisht sepse netët dhe mbrëmjet janë më të gjata, sepse errësohet herët dhe ritmi i jashtëm ngadalësohet, ne mund të marrim më shumë kohë për veten dhe për njerëzit tanë. Mund të krijojmë hapësirë për biseda më të gjata me fëmijët, të kalojmë më shumë kohë me të moshuarit dhe t’u japim atyre vëmendjen që shpesh u mungon, të ftojme miq në shtëpi, të lexojmë, të reflektojmë dhe të ushqejmë lidhjet që i lëmë pas dore gjatë muajve të ngarkuar. Kjo është një mënyrë e shëndetshme për t’u përshtatur me stinën, duke e pranuar se ne nuk jemi robotë që funksionojmë njësoj në çdo muaj të vitit. Ne jemi njerëz të lidhur me natyrën, me tokën dhe me ritmet e jetës, dhe si të tillë është normale që të përshtatemi me ritmin e stinëve.

Në fund, mesazhi kryesor është ky: nëse ndihesh “down” në janar, kjo nuk do të thotë se je i dobët dhe as se po e tepron duke u ankuar. Shpesh, është reagim normal i mendjes dhe trupit ndaj një kombinimi biologjik e social. Por nëse simptomat zgjasin, rëndohen, të bllokojnë funksionimin, apo shoqërohen me dëshpërim të thellë, atëherë mbështetja profesionale është një hap i mençur dhe i shëndetshëm.

Dhe një gjë e rëndësishme për ta mbajtur mend: e vetmja gjë konstante në jetë është ndryshimi. Prandaj, pavarësisht ndjesisë së zyrtë, kujto se dielli lind përsëri dhe me të vjen edhe pranvera. Me ditë më të gjata, më shumë dritë dhe ngrohtësi, rikthehet edhe energjia, forcohet motivimi dhe hapet një frymëmarrje e re për mendjen dhe shpirtin.



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkendije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de




Boschring 6
56422 Wirges



**HAPËSIRA EKSKLUZIVE PËR
JETESË DHE BIZNES**



MARIGONA HILL



+383 49 162 000

+383 48 162 000

info@marigonahill.com

MARIGONA[®]
SUN



+383 48 226 111
marigonasun.com

Gruaja po më tradhton!

Teksa po flisnim unë dhe ime grua se si është mirë të kemi kujdes se mund të ndaheshim shkaku i një mosmarrëveshjeje të vogël që patëm ditë më parë lidhur me një ëndërr që kisha parë se si gruaja më tradhtonte, më luti të pinim çaj rusi. Pas çajit më tha se do t'ma përgatis edhe drekën, por u bëra xhentëlmen dhe i thashë se do të drekojmë në restorant.

Dhe, pas drekës së shijshme në restorant, i thashë gruas:

"E mirë paska qenë ëndrra, për besë. Nuk kisha menduar ndonjëherë se mund të del kaq e ëmbëll.

"Epo, është mirë kur m'i tregon ëndrrat, sepse përfitojmë të dy", më tha ajo. Më qeshet me të madhe dhe i premttoj se tani e tutje kam për t'ia treguar të gjitha ëndrrat, pos ndonjëres që mund të jetë pa lidhje, ashtu siç i thoshte babai nënës sime se edhe ëndrrat i kishte pa lidhje.

"Jo, edhe ato pa lidhje kanë njëfarë lidhje", thotë ajo.

"Pajtohem, grua, do t'i tregoj të gjitha", i premttoj unë, duke mbajtur rezervën se do ëndrra s'mund t'ia tregoj kurrë. "Eh, mirë, a do të m'i tregosh edhe ti mua të gjitha ëndrrat?", i them në vazhdim.

"Po, patjetër, çka do që shoh ëndërr do të tregoj", më tha ajo.

"Mirë, pra, me kënd ke parë ëndërr se je larë në Sarandë?", i them unë.

"Marrëveshja për ëndrrat vlen prej sot

e tutje", foli shpejt e shpejt, sepse di të dredhojë.

PSE GRUAJA MA KTHEN SHPINËN KUR FLE ME MUA?!

Dhe, fjalë pas fjale, gati i acaruar punët përsëri.

"A e sheh se edhe ti mban të fshehta prej meje!", i thashë me zë të ashpër.

Dhe, bimë në shtrat të egërsuar, shpinë për shpine, bile ajo e tërhoqi pak shpinën që të mos prekej me timen, sepse prej kushedi se çka sjell natën.

Kah ora 3 pas mesnate, i pagjumë, ngrihem të pi ujë dhe kur kthehem të bij në shtrat nis t'më silllet dhoma.

"Ndoshta po dridhet toka", i them gruas dhe ajo nga frika ngrihet shpejt.

"Nuk po dridhet toka, por koka jote, o njeri!", ma ktheu.

Por, meqë më silllej dhoma i them se unë po vdes grua.

Ajo shpejt një gotë ujë ma hedh në fytyrë. Nis të qajë dhe ma lag edhe qafën.

"Më doli ëndrra", them me vete.

Ajo më thotë se më ka rënë shtypja e gjakut, prandaj edhe më silllet dhoma.

"Ka mundësi, grua, por këtë s'e kam përjetuar më parë, e ndoshta tani e tutje mësohem", i them unë.

"Mos të lashtë Zoti pa grua!", kanë thënë të vjetrit, them unë.

"A po e sheh se e paskan pasur mirë kur kanë thënë kështu! Çka do kishe bërë sikur të mos isha unë tani?", foli me krenari.

"Hesht, se akoma nuk më ka kaluar! Mos bëj hopa para kohe! Vetëm nëse më kalon do të kesh arsye të lavdëroresh.

Ja, pra, ëndrra se ti ishte dashnore e shokut tim...

Kjo qenka tepër e rëndë", i them.

E ajo, në vend të fjalëve: "Natën e mirë", më thotë:

"Herëve të tjera mësohu të mos shohësh ëndrra, sepse hakmarrja qenka në orën 3 pas mesnate!"

S. M.

MARINA YOGA RETREAT

MARINA BAY X YOGA WITH BORA



24 – 25 JANUARY

GUIDED
YOGA

SHARED CIRCLE
MEDITATION

ZEN
SPA

FOR INFO & RESERVATION
+355 69 604 1000 | info@marinabay.al

Dreqi nuk më lë rehat!

*Teksa shkoja në zyre,
dy të rinj (djale e vajzë)
qëndronin prapa disa
veturave. Zakonisht,
dihet se çka bëjnë aty:
pinë duhan apo një
dreq e di...*

Më dhembti në shpirt kur i pash aty
të rinj të pinin duhan, sidomos kur e
solla në mendje se edhe im bir është i
moshës së tyre...

T'u them cilat janë pasojat, apo të mos
u them?

T'i qortoj apo të mos i qortoj?

E, po t'më kundërvihen çka do bëja?

Edhe një babë, Ahmeti, i kishte thënë
çdo ditë djalit të vet mëso.

Por, një ditë djali nervozohet dhe

i thotë: "Ahmet, ndoshta je kah e
tepron!".

Atëherë, ai, Ahmeti, i thotë vetes: "Val-
lahi edhe djali e kuptoi se e teprova!".

PINI ÇKA TË DONI POS MBI BETON MOS U ULNI!

Megjithatë, i përshëndeta sa për të
hyrë në muhabet me ta.

Pasi u thashë si jeni, ua tregova një
barsoletë, e që e kam dëgjuar që moti.
Një plakë, teksa kalon pranë do shkal-
lëve prej betoni, sheh disa të rinj ulur
mbi to.

"Çka po bëni aty, loke?", u thotë ajo.

I thonë: "Po pimë duhan".

Plaka dyshon në ta se nuk pinin vetëm
duhan, andaj u thotë: "Pini çka të doni,
pos mbi beton mos u ulni!".

Dhe, derisa ua tregova këtë barsoletë
të rinjve që ndodheshin para meje,

djali më tha: "Edhe pula qorre e qëllon
ndonjëherë kokrrën!".

...EDHE UNË NUK E KAM MIRË!

Pas këtyre fjalëve hyra në zyrë, pa
u thënë gjë tjetër dhe më kapi një
siklet...

Ndërkohë, gjithnjë e më shumë bëhe-
sha nervoz...

Vendi-vend nuk më zihej.

Po t'u thosha e kam për të mirën e
tyre, kushedi sa kanë pirë e ma thonë
ndonjë fjalë të rëndë...

Por, edhe po të mos u them gjë,
ndihesha në siklet se më brente
ndërgjegjja se si t'u dilja në ndihmë...

E, edhe unë, me këtë "mundim të
brendshëm", e që ma dhuruan ata dy
të rinj, me siguri, nuk e kam mirë...

Burim Bajrami



QETËSI, PAMJE
DHE ELEGANCË.

CIMA GRAND COMPLEX

Prishtina e Re

+383 49 509 090 www.cimaks.com



“T’i hangsha kulet po mirë po t’rrinë!”

AI: JAM MËRZITUR QË PO TË LYPIN BAJRAKTARËT!

“E kam marrë letrën tënde mbrëmë dhe jam mërzitur shumë që po të lypin ata, Bajraktarët.
Por, unë nuk heq dorë prej teje...
Dje, në ara, bukur të rrinin kulet...
Ishe e mahnitshme...
Nuk më hiqet merakun për ty nëse të japin.
Por, do gjejmë një dalje dhe do i flakim lotët.
Do të të grabis, tek e fundit...
Kemi ku të shkojmë nëse vjen puna deri aty...
Kam fol me dajën. Më ka thënë se mundemi me shkua te ai naj ditë, derisa të merren vesh burrat.
Nuk mendoj se zgjat shumë pajtimi, sepse baba yt nuk është njeri i keq.
Kur të pash dje në arë, m’u duk se ia more rrezet diellit!
Më shumë më ngrohje ti sesa dielli!
Natën edhe mua më ka ardhur zëri yt... E kam frikën e Bajraktarëve se janë të fortë ata. Kam dëgjuar se i kanë premtuar mesitit para të majme dhe ai çdo ditë po troket në derën e tyre...
Ofrohu kah lokja, se te ajo ke me e gjet shpëtimin!
Mbështjelle letrën me mindil, që t’ia marrë erën tëndel!”

AJO: RUAJE MINDILIN QË TA DHUROVA!

“Sot baba është sëmurë diçka...
Më duhet të shkoj në arë vetëm, ose me vëllanë e vogël.
Mindilin ta jap për me të tregu se jam e jotja dhe e askujt tjetër.
Por, nëse më japin me zor te

Bajraktarët, nuk di çka bëj...
Natën i dëgjova nënën dhe babën kah flisin.
Nëna nuk pajtohej të fejohej për atë burrin e Bajraktarëve.
Por, baba kish qejf unë me shkua te ta. Ndoshta i kanë fol pare...
Oh, Zot, sa shumë u mërzita, pastaj...
Dhe, mendova të iku me ty...
Pra, të ikim sa më shpejt, para se t’më japin për Bajraktarët!
E di se lokja më do dhe po mundohet të mos më fejojne pa dëshirën time...
Bile, e ka quajtur nënën time kudër që nuk po reagon edhe më ashpër kundër fejesës sime që po vjen...
Nëse më fejojne për Bajraktarët, më duhet me e përbirë një kerr me therë... Jeta ime do të shuhet si dielli kur perëndon...
Jam e mërzitur, nuk po më zihet vendi-vend kur po mendoj se mund të mos bëhemi bashkë”.

AI: NUK DO MARTOHEM ME ASKËND TJETËR!


“Shpirti jem, mindilin e mora dhe do e ruaj tërë jetën. Nëse të japin me zor te Bajraktarët, unë do të martohej me mindilin tënd!
Mindili që ma dhurove do ma kujtoj fytyrën tënde, lotët tu, mallin për ty...
Në të po i shoh sytë tu të zi, shpirtin tënd...
Nuk do të martohej kurrë me dikë tjetër, edhe pse baba po këmbëngulë se e kam kohën për martesë, kurse nëna, paksa e sëmurë, ka nevojë për dikë që e ndihmon në punët e shtëpisë...
Dhe, nëse fejohej a martohej ti, si do jetoj unë?! Çka do më duhet jeta pa ty?!”

Shënoi: S. M.



ARRIJE PESHËN IDEALE NË VITIN 2026

Viti 2026 është koha ideale për të investuar në shëndetin dhe formën trupore. Arritja e peshës ideale nuk është vetëm çështje kilogramësh, por një proces që kërkon qasje profesionale, teknologji të avancuar dhe kujdes të personalizuar për trupin.



Qendra e Dobësismit Kenda Center përdor pajisje moderne me nxehtësi që ndihmojnë në stimulimin e metabolizmit dhe reduktimin e yndyrës trupore. Teknologji si Thermal Nest, Space Therapy dhe Infralight veprojnë përmes nxehtësisë së kontrolluar, duke ndihmuar trupin të djersijë, të relaksohet dhe të aktivizojë proceset natyrore të pastrimit dhe formësimit.

Një tjetër metodë efektive që përdoret në Kenda Center është EMS (Electrical Muscle Stimulation), e cila aktivizon muskujt përmes impulseve elektrike. Kjo teknologji ndihmon në tonifikimin muskular, përmirësimin e qarkullimit dhe formësimin e trupit, edhe për ata që kanë pak kohë për aktivitet fizik.

Falë kombinimit të teknologjisë me nxehtësi, EMS dhe udhëzimit profesional, **Kenda Center ofron një rrugë të sigurt dhe efektive drejt peshës ideale.** Me mbështetje të vazhdueshme dhe metoda bashkëkohore, 2026 mund të jetë viti kur transformimi yt bëhet realitet.



Vetë e refuzova, vetë iu dorëzova!

Dua të mos më gjykoni për jetën time dhe gjërat që kam bërë, por t'më kuptoni. Po e shkruaj këtë përjetim që vajzat si unë të besojnë se, ndoshta, një ditë mund ta gjejnë princin e kaltër dhe ajo ditë nuk është shumë e largët. Dua që vajzat si unë të mos ndjehen të pashpresa, por të shohin larg dhe të mendojnë se edhe për to Zoti ka rezervuar një kapitull të bukur, një jetë të bukur dhe normale.

Jam nga Gjakova, studente në vitin e dytë master në Prishtinë.

Përpara se të nisesha për në fakultet prindërit më dhanë porositë, ku përveçse duhet të mësoja shumë dhe të kujdesesha që shpenzimet e mia të ishin sa më të ulëta, porosia kryesore e nënës ishte ta ruaja nderin.

Fillimisht këtë e bëra, derisa u dashurova marrëzisht në një djalë, në një djalë të keq. Qëndrova një vit me të dhe për hir të dashurisë që kisha për atë të mallkuar, pranova të bëja shumë gjëra të këqija. Në fillim ai më merrte me shoqërinë e tij, më prezantonte me njerëz të ndryshëm, kryesisht meshkuj që ishin shumë më të moshuar se unë, por edhe më të moshuar se i dashuri im.

Për çudi, një ditë më kërkoi të dilja me një shok të tij.

"Do kënaqesh, vetëm do kërceni në diskotekë. Ai do një shoqe që të bëjë figurë të mirë në sy të miqve të tij, vetëm kaq, të

tregoj se gjoja ka të dashur. Nuk të prekë, ki besim, ai është shoku im më i mirë", më tha.

Pranova, por ajo mbrëmje nuk do të ishte ashtu si ai ma kishte përshkruar.

Shoku i tij fillimisht më prekte me duar dhe më bënte me shenjë që të buzëqeshja.

U PUTHËM GJATË GJITHË MBRËMJES...

U puthëm gjatë gjithë mbrëmjes, më prekte ngado.

U përpoqa të lidhesha me të dashurin tim, por ai nuk e hapte telefonin.

Si përfundim ikëm nga diskoteka.

Shoku i të dashurit tim më tha se do t'më shoqëronte me veturë. Hipa në veturë dhe u skuqta komplet nga turpi, nga inati dhe ndjenja e fajit.

Ai qeshi, i dha gaz veturës dhe u gjendëm në rrugë.

Vetura nuk po ecte më në drejtim të

shtëpisë sime, por në një rrugë tjetër, që unë nuk e kisha parë më parë.

Unë me ngulm kërkova që të shkonim në shtëpi se isha e lodhur dhe ishte vonë.

Dhe, pa një e pa dy dola nga vetura dhe u nisa rrugës në këmbë.

PAS NJË VITI E KËRKOVA VETË!

Më nuk u takuam një kohë të gjatë, sepse e urreja, por me kohë ndieja nevojë të jem pranë tij meqë nuk më hiqej nga mendja përjetimi i asaj nate në errësirë.

Dhe, një vit më pas e kërkova vetë.

E gjeta dhe u habit kur më pa.

E, kur i thashë se dua të jem me të, më buzëqeshi dhe më përqafoi fort e fort...

Sivjet në verë, kësmet, planifikojmë të bëjmë dasmë.

Sidoqoftë, jam bindur se në jetë po ndodhkan edhe gjëra të pabesueshme...

D. E.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Ku e ka vajza fatin?

E dashura magjistare, na ke ndihmuar dy herë, duke na i zgjidhur problemet.

Kërkojmë përsëri të na hapni rrugë për fatin e vajzës së dytë, që ende nuk e ka gjetur fatin e ri.

Vajza ka qenë e martuar tri vjet dhe janë ndarë...

A do të ketë fat të martohet përsëri dhe ku do ta ketë fatin e ri?

“Nëna e mërzhitur”

Përgjigje:

Shoh se ajo do të martohet gjatë verës, në fillim të shtatorit. Do ta gjejë fatin e ri në rrethinën tuaj, por jetë do të bëjë në Gjermani...

Probleme me gruan që punon

Motër e nderuar, jam një burrë nga Gjilani.

Jemi familje me traditë.

Jam 41-vjeçar, i martuar para tre muajsh.

Bashkëshortja ime punon, por kam dyshime se nuk rri si duhet në punë...

Çka të bëj, të lutem?

“Gjilani”

Përgjigje:

Nuk do ishte keq ta presësh gruan afër vendit të punës dhe ta marrësh në shtëpi, sepse ashtu do ia lehtësosh edhe udhëtimin.

Dhe, në këtë mënyrë i largon edhe dilemat që i ke për gruan...

Do të ndahemi, apo?

Përsëndetje zonjë, jam lexuese e rregullt e rubrikës tënde dhe të admiroj shumë për punën që bën.

Të kam shkruar shumë herë dhe më je përgjigjur para tri vitesh, për çka të falënderohem nga shpirti, sepse përgjigja juaj ka qenë udhërrëfim për mua.

Jam 44-vjeçare, me profesion daktroreshë, e pamartuar, punoj në profesionin tim.

Para një viti fillova një lidhje me një person nga Shkupi, e që jeton në Zvicër.

Bisedonim gjatë dhe arsyeshem dhe u takuam disa herë, për të filluar, më në fund, rregullimin e dokumenteve për atje. Por, në këtë fazë filluan edhe problemet tona. Ai shprehte shumë xheloz,

më akuzonte e më ofendonte, duke më etiketuar se e tradhtoja.

Kjo mënyrë e sjelljes së tij vazhdoi për disa kohë dhe para pak ditësh kur ishte në Kosovë më tha se do të ndahet.

Si të sillem me këtë person?

“Zemërthyer”

Përgjigje:

Jeni njohur me personin i cili nuk krahasohet me mentalitetin tuaj intelektual dhe psikologjik.

Te ai shoh qëllim të caktuar, i cili deshifrohet me gatishmërinë për ndarje.

Ai është sjell mirë në kohën sa nuk ka filluar procesi i rregullimit të letrave tua për të shkuar në Zvicër.

Dhe, kur e keni hapur këtë problem, sharra ka hasur në gozhdë! Prandaj, shihet qartë se qëllimi i tij nuk është serioz.



Sugjerimi im është të tërhiqesh, sepse nuk është njeri i duhur për ty. Nuk keni të njëjtin rang intelektual e as profesional. Prandaj, martesë nuk është vetëm dashuri, por, para së gjithash, interes jetësor.

Aty ku ka vetëm dashuri shpejt bie sistemi martesor. Kur funksionon sistemi i interesave tua të përbashkëta, e që i jep fizionomi dhe përmbajtje martesës, atëherë ju i fitoni arsyet për të qenë në jetë bashkëshortore.

Këto elemente ai nuk i ka pranuar, prandaj ka rënë lidhja juaj nga sistemi.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP




@dentfix ks


+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC